



AKT THEMELIMI

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"Geri - 01" SHPK

NENI 1

FORMIMI

Ne baze te Ligjit 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare" si dhe Ligjit 7667 dt 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregetar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te", themeloj me vullnetin tim te lire Shoqerine Tregtare me pergjegjesi te kufizuar, me emertim "Geri - 01" Sh P K, me Ortak te vetem Caush Qato

NENI 2

SELIA

Selia e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "Geri-01" Shpk eshte ne Polcan, Skrapar

NENI 3

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Geri-01" Shpk eshte mbi dhjete vjet

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise "Geri - 01" Shpk eshte:

Ne fushen e tregetise, import eksport me shumice e pakice, tregetim te mallrave industriale, ushqimore, blektorale e bujqesore, tregetim me pakice te karburanteve prodhim e tregetim te materialeve te ndertimit, blloqe, gurore kariere, materiale inerte, veshmbathje, paisje hidrosanitare, artikujve kozmetike, ne fusha te tjera hapje bar bufe, restaurante, te hoteleve, pika servisi, lavazhe, moteleve, si dhe trasport te udhetareve e mallrave si brenda e jashte vendit.

NENI 5

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themelor i shoqerise "Geri - 01". Shpk eshte 100.000 /njqind mije/Leke

Qato

NENI 6

ORGANET E SHOQERISE DHE ASAMBLEJA

Te gjitha kompetencat Asamblese I takojne Ortakut te vetem Caush Qato

Vendimet e Ortakut te vetem regjistrohen ne libri i shoqerise.

NENI 7

Te drejtat e detyrat e Ortakut te vetem ,organizimi i shoqerise,mardheniet me persona fizike e juridike,vendas apo te huaj, shprehen ne statut qe bashke me aktin e themelimit jane dokumentat baze te veprimtarise dhe sherbejne per zhvillimin e mardhenieve ne kete fushe.

NENI 8

Veprimtarine e saj, shoqeria do ta zhvilloje ne perputhje me legjislacionin Shqiptar

NENI 9

Te gjitha mosmarveshjet me persona fizike ose juridike si dhe me organet shteterore zgjidhen me mirekuptim,me ane te depozitave te ketij akti,statutit dhe legjislacionit shqiptar dhe kur keto mjete nuk japin rezultat atehere zgjidhen me gjykate.

Ky Akt Themelimi hyn ne fuqi dite e regjistrimit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuara "Geri - 01" Shpk ne Gjykatën e Rrethit Tirane,ne kete dite shoqeria "Geri-01" SHPK njihet si person juridik.


ORTAKU I VETEM
CAUSH QATO
Caush Qato
Qy

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTERE DRITA PEPI
NR 5833 REP

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 31.10.2003,para meje Notere Drita Pepi me Adrese ne Bulevardi "Zhan D'Ark",prane Gjykates se Shkalles se Pare,Tirane u paraqit personalisht Shtetesi Caush Qato, I datelindjes 24.02.1977,me banim Polican,Skrapar,madhor, me zotesi juridike per te vepruar, Identifikuar me ane te Pasaportes nr.Z0204677, dhe deklaroi se Akti I Themelimit, redaktuar jashte kesaj zyre,eshte sipas vullnetit te tij dhe e ka nenshkruar ,une noterja vertetoj nenshkrimin sipas ligjit.

NOTERE
DRITA PEPI





STATUT
I SHOQERISE TREGETARE
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Geri - 01" SHPK

NENI 1

FORMIMI

Ne baze te Ligjit 7638 dt 19.11.1992 "Per Shoqerine tregtare" si dhe Ligjit 7667 dt 28.01.1993 Per Regjistrin tregetar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te, themelohet, me vullnetin tim te lire, shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin "Geri-01" Shpk me Ortak e Administrator I vetem Caush Qato

NENI 2

SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Geri-01" Shpk eshte ne Poliçan, Skrapar .Kjo shoqeri, gezon te drejten e hapjes e bashkepunimit me filjalet si brenda ashtu dhe jashte vendit.

NENI 3

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Geri-01" Shpk eshte mbi dhjete vjet. Shoqeria mund te pushoje veprimtarine e saj , me vendim te Ortakut te vetem apo kur verifikon rethana te tilla kur shpemdarda urdherohet ne menyre te shprehur ne ligj.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Geri-01" Sh.p.k. eshte:

Ne fushen e tregetise, import eksport me shumice e pakice, tregetim te mallrave industriale, ushqimore, blektorale e bujqesore, tregetim me pakice karburant, prodhim e tregetim te materialeve te ndertimit, blloqe, gurorë kariere, materiale inerte, veshmbathje, paisje hidrosanitare, artikujve kozmetike, ne fusha te tjera hapje bar bufe, restaurante, te hoteleve, pika servisi, lavazhe, moteleve, si dhe transport te udhetareve e mallrave si brenda e jashte vendit.

Qato



NENI 5

Shoqëria, mund të ndryshojë emërtimin, seline, objektin e veprimtarisë së saj me vendim të Ortakut të vetëm

NENI 6

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Geri-01" Shpk është 100.000 Leke i investuar nga Ortaku i vetëm Caush Qato

Ai mund të shtohet me vendim të Ortakut të vetëm

NENI 7

Shoqëria ka të drejtë të lere peng një pjesë të kapitalit të saj themeltar. Në rast shitje të detyruar të pjesëve të lena peng, pengmarsi do të pranohet si person të cilit i janë transferuar pjesë të kapitalit, me përjashtim të rastit kur shoqëria preferon të blerë ato dhe të deklarojë zvogëlimin e mundshëm të kapitalit themeltar.

NENI 8

ORGANET E SHOQERISE, ADMINISTRIMI

Të gjitha kompetencat e Asamblese i takojnë Ortakut të vetëm

Vendimet e Ortakut të vetëm në përputhje me ligjin, dhe normat e këtij statuti janë të detyrueshme për të gjithë. Ato regjistrohen në librin e shoqërisë.

Ortaku i vetëm vendos emërim apo shkarkim ekspert, kontabilistit të autorizuar dhe likuiduesve, miratimin e llogarive vjetore, ndarjen e fitimit etj

Gjithashtu Ortaku i vetëm vendos për ndryshim Statutit, zvogëlim ose zmadhim të kapitalit themeltar, por jo më pak se 100.000 leke, si dhe likuidimin e saj.

Ortaku i vetëm është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të Ligjeve, statutit apo faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 9

Cdo i interesuar mund të kërkojë në Gjykatë anulimin e vendimit të Ortakut të vetëm të marrë në kundërshtim me ligjin apo normat e këtij statuti.

NENI 10

Administrator i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Geri-01" është Caush Qato

3.



NENI 11

Ortaku I vetem kryen cdo veprimtari ne interes te shoqerise brenda objektit te veprimtarise se saj.

NENI 12

Shoqeria mer persiper detyrimet qe rjedhin nga aktet e administratoreve dhe kur keto nuk perfshihen ne objektin e veprimtarise se saj, me perjashtim te rasteve kur ajo provon se te tretet e dinin se akti i administratorit tejkalonte objektivin e shoqerise apo kur rethanat nuk mund te injoronin kete fakt.

NENI 13

Ortakut te shoqerise I takon firma e shoqerise dhe perfaqsimi i saj ndaj te treteve.

NENI 14

BILANCI DHE FITIMET

Viti financiar i shoqerise mbyllet me date 31.12. te cdo viti. Ortaku ben inventarin dhe llogarite vjetore sipas dispozitave te kontabilitetit dhe harton nje raport me shkrim per administrimin Bilancit i bashkohet

- nje situacion per garancite e dhena nga shoqeria
- nje situacion per sigurimet e bera nga shoqeria.

NENI 15

Perderisa "rezerva e domosdoshme" te arrije 1/10 pjese te kapitalit themeltar shoqeria eshte e detyruar te depozitoje 1/20 e fitimit te realizuar.

NENI 16

Fitimet, pasi te jene depozituar shumat e urdheruara per rezerven e te tjera, i takojne ortakut. te vetem te shoqerise

NENI 17

Bilanci vjetor duhet te paraqitet ne organet tatimore, pasi miratohet nga Ortaku, brenda dates 31.03. te vitit pasardhes.

NENI 18

Ne rast te likuidimit te shoqerise, caktohet likuidatori, duke qene i detyruar te njoftoje per punet e shoqerise.

Qefte

4.

NENI 19

MARDHENIET E PUNES

Mardheniet e punes ne shoqeri regullohen nepermjet dispozitave te Kodit te Punes se Republikes se Shqiperise.

Te gjithë personat e punesuar ne shoqerine "Geri-01 " Shpk kane te drejte te percaktojne mardheniet e punes nepermjet Kontrates se Punes dhe Kontrates Kolektive te Punes.

NENI 20

Mosmarveshjet e punes zgjidhen nga Gjykata e Rrethit, kur mjetet e tjera nuk japin rezultat. Shoqeria respekton regullat e punesimit dhe te Sigurimeve Shoqerore, ndersa te punesuarit jane te detyruar qe ti pranojne e zbatojne ato. Te gjithë te punesuarit jane te detyruar te ruajne sekretin e punes.

NENI 21

Ortaku I vetem percakton, perfaqsimin e shoqerise ne mardhenie me te tretet, organet gjyqesore, caktim te avokatit si dhe ne mardhenie me sistemin fiskal e organet e tjera shteterore.

NENI 22

Gjithe veprimtaria e shoqerise ne aspektin ekonomik drejtohet nga Ortaku I vetem, Pjesmarje me shoqeri te tjera, ndryshim statuti, kapitali themelor, miratim bilanci, pranim ortake te rinj percaktohet nga Ortaku I vetem

NENI 23


MBARIMI I SHOQERISE

Veprimtaria e shoqerise mbaron me vendim te ortakut te vetem ,ne rastet e parashikuara ne ligj.

NENI 24

LIKUIDIMI I SHOQERISE

Likuidimi I shoqerise do te behet sipas dispozitave te Legjisllacionit shqiptar ne fuqi dhe ne çastin e likuidimit
Kur shoqeria kalon ne proceduren e likuidimit Ortaku cakton komisionin e likuidimit, te cilit I paraqet pasqyrat e bilancit te likuidimit dhe shoqeria mbyll aktivitetin e saj ne momentin kur ky bilanc aprovohet
Pasuria e shoqerise ,pasi shlyhen detyrimet e shoqerise, I kalojne ortakut te vetem



NENI 25

Likuidimi i shoqerise vendoset me vendim te ortakut te vetem i cili per te kryer veprimet qe kerkohen, emerom nje likuidator me tagrat e percaktuara ne ligjin 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite Tregetare". Likuidatori eshte pergjegjes si ndaj shoqerise ashtu dhe ndaj te treteve. Ai shperblehet ne baze te vendimit te Ortakut te vetem.

NENI 26

Likuidatori i emeluar perfaqson shoqerine dhe nenshkruan duke vene firmen nen vulen e shoqerise. Ai duhet te perfundoje shitjet qe jane te disponueshme per llogari te shoqerise, te mare nga cdo debitor llogari te sakta ne monedhe dhe te ketheje pasurine e shoqerise ne para. Per ceshtjet e mbetura pezull vendos Ortaku i vetem shoqerise per zgjidhjen e tyre. Ne perfundim te likuidimit te shoqerise likuidatori perpilon bilancin perfundimtar dhe te nxjere buletin perkates.

NENI 27

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Persa nuk eshte shprehur ne kete Statut, do te zbatohen dispozitat e Ligjit 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" Ligji 7667 dt 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar, si dhe cdo dispozite te Legjislacionit Shqiptar qe gjen vend ne keto mardhenie juridike e tregetare.

NENI 28

Shoqeria fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane

ORTAKU I VETEM

CAUSH QATO

Caush Qato
Qato

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTERE DRITA PEPI
NR 5334 REP

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 31.10.2003, para meje Notere Drita Pepi me Adrese ne Bulevardi "Zhan D'Ark", prane Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane u paraqit personalisht Shtetesi Caush Qato, i datelindjes 24.02.1977, me banim Polican, Skrapar, madhor, me zotesi juridike per te vepruar, Identifikuar me ane te Pasaportes nr Z0204677, dhe deklaroi se Statuti, redaktuar jashte kesaj zyre, eshte sipas vullnetit te tij dhe e ka nenshkruar, une noterja vertetoj nenshkrimin sipas ligjit.

NOTERE
DRITA PEPI

